



**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MEDYKAL INDUSTRIES” SHPK.**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Sot, më 22 qershor 2020, ne Tirane, Ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**MEDYKAL INDUSTRIES**” shpk vendosim miratimin e Statutit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**MEDYKAL INDUSTRIES**” shpk si më poshtë:

**Neni 1:
Ortakët e Shoqërisë**

Ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**MEDYKAL INDUSTRIES**” shpk janë si më poshtë;

1. Z. **Andrea Nicolotti**, i biri i Giuseppe, shtetas italian, lindur më 30.12.1975, në Como, Itali mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. CA92389DU, banues në adresën: Como, Itali.
2. Z. **Matteo Baroncelli**, i biri i Luca, shtetas italian, lindur më 14.09.1993, në Prato, Itali, mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. AX6966900, banues në adresën: Prato, Itali.

**Neni 2
Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është “**MEDYKAL INDUSTRIES**”, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 3
Forma ligjore**

Ortakët bien dakord që “**MEDYKAL INDUSTRIES**” shpk është krijuar dhe do të vazhdojë aktivitetin e saj në bazë të këtij Statuti ne formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me dispozitat e Pjesës IV të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 4:
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Import – Eksport te Produkteve Mjekesore
2. Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 5:
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka për objekt përnjë periudhe kohore me afat të pacaktuar.

Neni 6:
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga: "Abdyl Frasheri" pallati Nr.31,Kati 8,Tirana,Albania. Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, më shumicë të thjeshtë votash, mund të vendosë, të ndryshojë selinë, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II
Kapitali

Neni 7
Kapitali themeltar

Numri i përgjithshëm i kuotave në shoqëri është 2 (dy).

Kapitali i shoqërisë është 1000 leke(një mijë) Lekë. Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me zotërimin e tyre të përqindjeve në shoqëri si më poshtë:

1. Ortaku **Andrea Nicolotti**: Zotërues i 1 (një) kuote/pjese me vlerë të përgjithshme 500 leke(pesëqind) lekëqë përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.
2. Ortaku **Matteo Baroncelli**: Zotërues i 1 (një) kuote/pjese me vlerë të përgjithshme 500 leke (peseqind) lekë që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Ne rast se njëri nga ortakët kërkon të transferojë, nëpërmjet shitjes, dhurimit, apo të çfarëdo forme tjetër tjetërsimi një pjese ose të gjithë kuotën që ai zotëron në shoqëri, ai është i detyruar që t'ia ofrojë paraprakisht këtë kuotë ortakëve të tjerë të shoqërisë, ose vetë shoqërisë me të njëjtin çmim që ai ka vendosur ta shesë atë. Kjo ofertë do të quhet e marrë nga ortakët e tjerë dhe/ose nga shoqëria, në momentin e depozitimit të saj në selinë e shoqërisë.

Në rast se ortakët e tjerë të shoqërisë, ose shoqëria, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të ofertës nuk përgjigjen për këtë ofertë, ose refuzojnë ofertën, ortakët ofertues ka të drejtë t'ia transferojë lirisht kuotën e tij ose një pjesë të saj palëve të treta.

Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Në rastin e trashëgimisë, kuotat dhe pjesët e kapitalin i kalojnë lirisht trashëgimtarëve të ligjshëm të ortakut. Në këtë rast kalim i kuotave miratohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicë të thjeshtë votash.

WJOLA COVA
Traduttor dhe Gjyko
Përkthyes dhe Konsullar

Neni 8:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit, ose të secilit prej ortakëve të shoqërisë.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, në përputhje me parashikimet dhe kufizimet e Nenit 7 të këtij Statuti.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë dhe i vetëm, vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) transferimin dhe/ose tjetërsimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të shoqërisë.
- m) marrjen dhe dhënien e kredive ose të huave për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Çdo Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Si rregull Asambleja e Zakonshme e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, thërret të paktën një herë në 6 muaj.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, mblidhet nëçdo kohë, në bazë të kërkesës së administratorit ose të njërit prej ortakëve të shoqërisë, sipas rregullave të përcaktuara më poshtë në këtë Nen.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Njoftimet që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas këtij Statutit duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën elektronike të personit dhe është e vlefshme në momentin dhe që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bën njoftimin.

Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut.

Njoftimi me shkresë quhet i marrë nga Ortaku në momentin e konfirmimit nga ana e zyrës postare përkatëse për dërgimin e njoftimit.

Njoftimi me postë elektronike (e-mail) konsiderohet i marrë në momentin kur marrësi i mesazhit elektronik (e-mailit) dërgon konfirmimin e marrjes së mesazhit tek personi që e ka nisur mesazhin

elektronik. Në rast se konfirmimi i marrjes nuk dërgohet brenda 3 ditëve, njoftimi do të quhet i marrë.

Ortakët e Shoqërisë dhe administratori do të depozitojnë tek Administratori i shoqërisë adresat e tyre të njoftimit me postë normale dhe adresat e postës elektronike. Për çdo ndryshim të këtyre të dhënave, ortakët duhet të njoftojnë shoqërinë, nëpërmjet Administratorit.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafëve më lart të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të mbahet një proces-verbal, i cili do të nënshkruhet nga ortakët pjesëmarrës në mbledhje, administratori i shoqërisë, në rast se merr pjesë në mbledhje dhe nga mbajtësi i proces-verbalit.

Proces-verbalet do të ruhen në një regjistër/skedar/dosje të veçantë të shoqërisë dhe do të jenë të aksesueshme të lexohen në çdo kohë nga çdo ortak apo administratori.

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të regjistrohet në një regjistër të vendimeve të shoqërisë.

Neni 12

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të pjesëmarrjes në shoqëri.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 3/4 e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar të votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a) ndryshimin e statutit;
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- c) shpërndarjen e fitimeve;
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- e) marrjen dhe dhënien e kredive ose të huave për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë.
- f) transferimin dhe/ose tjetërsimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të shoqërisë.

- g) miratimin, sipas rastit, të furnitorëve, bashkëpunëtorëve të biznesit, ofrues të ndryshëm mallrash dhe shërbimesh, qofshin këta individë, tregtarë apo shoqëri tregtare të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 14

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorët shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratoret e shoqërisë janë:

1. **Z. Andrea Nicolotti**, i biri i Giuseppe, shtetas italian, lindur më 30.12.1975, në Como, Itali mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. CA92389DU, banues në adresën: Como, Itali.
2. **Z. Matteo Baroncelli**, i biri i Luca, shtetas italian, lindur më 14.09.1993, në Prato, Itali, mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. AX6966900, banues në adresën: Prato, Itali.

(Specimeni i nënshkrimit)



Neni 16

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane të drejtë dhe detyrohen bashkarisht të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të zbatojnë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve.
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret jane te detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- Kur për nevoja të shoqërisë, duhet të kryejnë veprime financiare apo transaksione që kalojnë vlerën prej 100.000 euro (njqind mijë) euro ose ekuivalentin e saj në monedha të tjera, për një transaksion të vetëm ose disa transaksione brenda të njëjtit muaj kalendarik.

Administratoret kane të drejtë te kryejne vecmas secili:

- a) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- b) Kur për nevoja të shoqërisë, duhet të kryejnë veprime financiare apo transaksione deri në vlerën prej 100.000 euro (njqind mijë) euro ose ekuivalentin e saj në monedha të tjera, për një transaksion të vetëm ose disa transaksione brenda të njëjtit muaj kalendarik.
- c) Administratorët kanë të drejtë lidhin kontrata pune me individë të ndryshëm për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë, sipas objektit të aktivitetit të saj

Administratoret do të përfitojnë një shpërblim për punën e tij, sipas vendimit me shumicë të thjeshtë votash (vendim i zakonshëm) të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

Administratoreve do u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit, apo të tjera shpenzime që kryhen në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratoreve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Neni 17

Përgjegjësitë e Administratoreve

Administratoret janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratoreve dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratoret detyrohen:

1. a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratoret, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratoret veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'ë dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratoret kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratoret janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi ose hua në emër të shoqërisë.

Administratoret, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve kanë të drejtë t'u delegojnë me prokurë një pjesë të kompetencave të tyre, personave të tretë të caktuar prej tyre, por jo më shumë se për një periudhë 6 mujore. Administratoret nuk mund të delegojnë asnjërin prej detyrimeve të cilat ia ngarkon ligji atij për ushtrim.



Neni 18

Shpërndarja e Fitimit/Dividendi

Në fund të vitit financiar, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat që ata zotërojnë në shoqëri.

Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë me vendim të kualifikuar shpërndarjen e dividendit në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 19

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atëgjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer njëgjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atëpër kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'i aparaqesë e dorëzojë në kohe ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në Statutin e shoqërisë;
- b) me vendim të kualifikuar Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 22

Riorganizmi i shoqërisë. Bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Ndryshimet

Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të kualifikuar të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Përmosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.


ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

MEDYKAL INDUSTRIES


Z. Andrea Nicolotti

ANDREA NICOLOTTI



Z. Matteo Baroncelli

BARONCELLI MATTEO



per shërbime të ligjshme

VJOLA GODA
Traduttore Giurato
Perkthyes i Licensuar

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 611 Rep.



V È R T E T I M

Në Tiranë, sot më 22 qershor 2020, përpara meje Genci Duraj, Noter i Dhomës së Noterëve Tirane, me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u paraqiten personalisht:

1. Z. **Andrea Nicolotti**, i biri i Giuseppe, shtetas italian, lindur më 30.12.1975, në Como, Itali mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. CA92389DU, banues në adresën: Como, Itali.
2. Z. **Matteo Baroncelli**, i biri i Luca, shtetas italian, lindur më 14.09.1993, në Prato, Itali, mbajtës i Kartes se Identitetit italiane me nr. AX6966900, banues në adresën: Prato, Itali.

në cilësinë e Ortakëve Themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MEDYKAL INDUSTRIES" shpk.

Ata jane persona madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ata mbanin.

Pasi unë Noteri, ua lexova dhe ua shpjegova aktin bashkëngjitur këtij vertetimi, duke qenë se nënshkruesit jane shtetas italiane, në prani të perkthyeses zyrtare e gjuhes italiane, Znj. Vjola Goda, e njohur personalisht prej meje noterit, ata më deklarojnë se e kuptojnë, e pranojnë dhe se e kanë hartuar atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, dhe e nënshkruajnë rregullisht në praninë time, gjë të cilën unë Noteri e vërtetoj sipas ligjit.

Përkthyesja Zyrtare

Vjola Goda



NOTERI
Genci K. Duraj

Genci K. Duraj



[Handwritten signature]

Nicolotti